



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:237421

Datë: 09.10.2024

Numri i dokumentit: 06273817

C.nr.230/2006

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka në çështjen juridike kontestimore të paditësit H. D. nga Obiliqi të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M. D., jurist nga Prishtina, kundër të paditurit Z. Ll. me adresë të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme av. F. A. nga Prishtina, lidhur me çështjen juridiko-kontestimore vërtetim pronësie, jashtë seance me datë 07.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET së është tërhequr padia e paditësit H. D. nga Obiliqi të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M. D., jurist nga Prishtina, kundër të paditurit Z. Ll. me adresë të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme av. F. A. nga Prishtina, lidhur me çështjen juridiko-kontestimore vërtetim pronësie, lënda sipas shenjës C.nr.230/2006.

A r s y e t i m

Me datë 03.03.2006, paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurit Z. Ll., me objekt kontesti vërtetim pronësie pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Gjykata caktoj dhe mbajti seancën përgatitore me datë 24.01.2024. Pas mbajtjes së seancës përgatitore gjykata caktoj seancën e këqyrjes në vend dhe mbajti të njëjtën me datë 06.03.2024. Seanca e shqyrtimit kryesor u caktua me datë 11.06.2024, për të cilën përfaqësuesi i palës paditëse parashtrij kërkesë për shtyrje. Gjykata aprovoj kërkesën për shtyrje dhe caktoj

seancën e shqyrtimit kryesor për datën 07.10.2024. Pala paditëse ftesën e Gjykatës për seancën e datës 07.10.2024 e ka pranuar me datë 25.09.2024 mirëpo në seancë nuk ka prezantuar dhe mos prezencën e tij nuk e ka arsyetuar.

Me qenë se paditësi i ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar në seancë përgatitore, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 423 par. 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 230/2006, më 07.10.2024

Përparim Zeka

---

Gjyqtar

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të së njëjtit, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të dorëzohet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.